



Teuta ka marre nje tjeter fitore te madhe ne Kavaje. Djemte e Detit kane mundur skuadren e Vllaznise ne nje ndeshje spektakolare qe solli pese gola te shenuar. Teuta me kete fitore ka konsoliduar pozitat ne kreun e tabelës dhe tani mendon me shume se cdo here tjeter per titullin kampion. Super Daniel Xhafaj i ka dhene durrsakeve fitoren ne nje ndeshje qe dukej sikur do te humbej. Vllaznia ka marre humbjen e dyte rradhazi dhe tani forma e fillimit duket se eshte lene pas. Ne pjesen e pare, bomber i kampionatit Daniel Xhafaj ka zhbllokuar rezultatin ndersa ne pjesen e dyte, kroati Bushic ka shenuar dy gola duke e permbusur ate. Kur dukej se do te mbaronte me fitoren e kuqeblove, skuadra e Maganit ka gjetur forca ta permyse disavantazhin. Fillimisht Nika dhe me pas Xhafaj kane realizuar dy gola te shpejte per ti dhene Teutes nje super trepikesh.

[Skeda e ndeshjes Teuta-Vllaznia](#)